




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 492/1 Prot
Dt. 10.02.23



Nr. 113/1 prot.

Shkodër më 9.02.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 1, datë 25.01.2023 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës



KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, Kreu IV, pika 1, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i ndryshuar, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 1, datë 25.01.2023 “Mbi kriteret për familjet për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për vitin 2023”.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM
Nr. 01 Date 15.01.2023



Mbi Kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi kushtezuar deri ne 6% per vitin 2023

Bazuar ne ligjin nr.9355,date 10.03.2005”Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore “(ndryshuar),eshte shfuqizuar nga ligji nr 57/2019” Per Asistencen Social ne Republiken e Shqiperise”, VKM nr.955 date 07.12.2016”Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhimes Ekonomike” te ndryshuar, eshte shfuqizuar nga VKM nr,597,dt.04.09.2019”Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike”

KESHILLI BASHKIAK :

VENDOSI

Te miratohen Kriteret Specifike per vitin 2023 mbi te cilat do te bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak per te trajtuar me ndihme ekonomike duke perdorur deri ne 6% te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike,familjet te cilat nuk shpallen fitues sipas formule se pikezimit.

- 1-Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme,qe nuk plotësojne nevojat bazë per jetesë.
- 2-Familje qe kanë ne përberje nje ose me shumë anetare me aftësi te kufizuar/invalid pune.
- 3-Familje me shume femijë
- 4-Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme,dhe me probleme sociale.
- 5-Persona qe jetojnë te vetëm ,te moshuar, qe kanë dhe probleme shendetesore .
- 6-Familje me te ardhura te pamjaftueshme qe ka në perberje femijë qe ndjekin arsimin e lartë.
- 7-Familjet qe nuk kanë banese ose jetojnë me qera.
- 8-Familje qe kanë ne përberje të moshuar, qe nuk kane pension ose e kane pension minimal.
- 9-Kryefamiljare gra te veja apo te divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme.

I-Dokumentat e aplikuesve jane sipas VKM nr.955 date 07.12.2016”Per percaktimin e kritereve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhimes Ekonomike”.te ndryshuar *eshte shfuqizuar nga VKM nr,597,dt.04.09.2019”Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike”*


II-Masa e ndihmes ekonomike llogaritet siopas VKM nr,597,dt.04.09.2019”Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike”

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Buqizimit Ekonomik.

SEKRETARI I KESHILLIT
Ardian CELEPIJA



KRYETARI I KESHILLIT
MARK BISHA



Miratuar me...¹⁹.....vota

Vota pro ..¹⁹.....

Vota kunder

Vota Abstenim

Zbardhur me date ^{27.01.2023}.....